



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Ne meritojmë një mjedis të pastër

Prishtinë

Shtator, 2014

Copyright © 2014

2014 Qendra për Politika dhe Avokim

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë doemosdoshmërishtë pikëpamjet e donatorit.

Botues:

Qendra për Politika dhe Avokim

Hartues të Raportit:

Agim Kelmendi dhe Milaim Morina

Mbeshtetur nga:

The ENV.Net është projekt i financuar nga Komisioni Evropian, menaxhuar nga Punto Sud dhe implementuar nga ATRC në Kosovë



Indeksi i shkurtesave

AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

ATRC - Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

BE – Bashkimi Evropian

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

QPA – Qendra për Politika dhe Avokim

VV – Lëvizja Vetëvendosje

I. Hyrje

Mjedisi dhe mbrojtja e tij janë ndër çështjet më shqetësuese, por edhe më me prioritet, të politikbërësve në të gjithë botën, ndërkohë që posaçërisht ngrohja globale po bëhet një shqetësim serioz për globin tokësor.

Në Kosovë, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioriteteve të politikbërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve qoftë në nivelin qendror, por veçanërisht në nivelin lokal. Në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta për nivelin e ndotjes së mjedisit, por zyrtarët e institucioneve qendrore pranojnë se ndotja tejkalon disa herë parametrat e lejuar nga BE-ja.

Shkaktarët më të mëdhenjë të ndotjes vlerësohet të jenë sektori i energjetikës, industria e rëndë dhe komunikacioni. Gjendja më e rëndë paraqitet në disa komuna ku operojnë disa kompani të mëdha siç është KEK-u në Obiliq, Ferronikeli në Drenas, Sharrçemi në Han të Elezit etj. Banorët e këtyre komunave ankohen se veprimtaria e këtyre kompanive po u shkakton shqetësime të mëdha mjedisore, pasi ato nuk po ndërmarrin masat e duhura për t'i mbrojtur ata nga ndotja.

Institucionet e Kosovës kanë miratuar disa akte ligjore për mbrojtjen e mjedisit, por ato po gjejnë shumë pak zbatueshmëri në praktikë.

Organizata joqeveritare Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), me mbështetjen e ATRC-së, në kuadër të projektit “Ne meritojmë një mjedis të pastër” paraqet raportin mbi dëmet mjedisore që po i shkakton kompleksi industrial “Ferronikeli” komunës së Drenasit, posaçërisht lumit Drenica.

Komuna e Drenasit – karakteristikat dhe veçoritë

Territori i komunës së Drenasit (ish-Gllogocit) shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore. Sipërfaqja e gjithëmbarëshme e kësaj komune përfshinë 290 km² apo 2.66 përqind të sipërfaqës së territorit të Kosovës¹. Gjithë kjo trevë, e cila përbëhet nga 42 vendbanime është e rrethuar me Malet e Berishës, Kasmaqit, Qyqavicës, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës). Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Sipërfaqet e tokës së Luginës së Drenicës i përshkon sistemi i ujitjes “Ibër”. E veçanta tjetër e kësaj treve është miniera dhe shkretorja e “Ferronikelit” si dhe disa gurore. Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbicë, uji i të cilave shfrytëzohet për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, Komuna e Drenasit ka një popullsi prej mbi 58,531² banorë. Popullata e kësaj komune jeton në 42 vendbanime dhe është e banuar ekskluzivisht vetëm nga shqiptarët. Një lëvizje pozitive në ekonominë e pazhvilluar të Drenasit është shënuar pas ndërtimit të kompleksit “Ferronikeli”.

¹ <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/City-guide/Historia.aspx>

² <http://ask.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Popullsia%20Sipas%20Gjinise%20Etnicitetit%20Dhe%20Vendbanimit.pdf>, fq.19.

II. Baza ligjore për mbrojtjen e ujërave

Mbrojtja dhe trajtimi i ujërave në territorin e Kosovës është e rregulluar edhe me legjislacion. Kuvendi i Kosovës ka miratuar disa ligje, MMPH ka nxjerrë disa akte nënligjore, gjithashtu janë adaptuar edhe disa direktiva të Bashkimit Evropian

II .a Ligjet:

- Ligji Nr. 2004/24 për Ujërat e Kosovës
- Ligji Nr. 02/L-79 për Veprimtarinë Hidrometeorologjike
- Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike
- Ligji Nr. 03/L-86 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Kanalizimeve dhe Mbeturinave
- Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore

II. b Aktet nënligjore:

- Udhëzimi administrativ për leje ujore
- Udhëzimi administrativ për strukturën e pagesave të ujit
- Udhëzimi administrativ për infrastrukturën ujore
- Udhëzimi administrativ për testimin dhe zbatimin e standardeve minimale për monitorimin e kualitetit të ujit të pijes
- Udhëzimi administrativ për inspektorët sanitarë
- Udhëzimi administrativ për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura ujore për burimet e ujit që shfrytëzohen për pije;
- Udhëzimi administrativ për vlerat kufizuese të lejuara të parametrave në efluent të cilat mund të shkarkohen në trup uJOR apo në rrjetin e kanalizimit publik.

II. c Strategjia e Kosovës për Mjedis

II. d Plani Strategjik i Kosovës për Ujëra

II. e Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis

II.f Direktivat e BE-së për ujërat

II.f.1 Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)

II.f.2 Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC)

II.f.3 Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)

II.f.4 Direktiva për nitratet (91/676/EEC)

III. Përmbledhje Ekzekutive

III.a Ndotja nga kompleksi industrial Ferronikeli

Komuna e Drenasit sot cilësohet si një ndër komunat më të ndotura në Kosovë dhe kjo vjen si pasojë e shkretitores së “Ferronikelit”, që është një nga problemet më shqetësuese mjedisore. Tymi që nxjerr kjo fabrikë ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullatës. Edhe AMMK në një raport të saj për cilësinë e ajrit në Kosovë, e rradhit Ferronikelin në mesin e operatorëve ekonomik që ndotin ajrin.³

Në këtë raport, Qendra për Politika dhe Avokim do të përpiqet të analizojë dëmet mjedisore që po u shkakton banorëve të Drenasit kompleksi industrial Ferronikeli.

Që nga viti 1984 kur edhe filloi punën, Ferronikeli i cili merret me prodhimin e hekurit dhe nikelit, është konsideruar si një nga gjeneratorët e zhvillimit ekonomik të Kosovës, posaçërisht për komunën e Drenasit. Por krahas efekteve pozitive, kjo industri e rëndë ka shkaktuar edhe dëme mjedisore, duke ndotur ajrin, ujin dhe tokën.

Mbetjet nga prodhimi industrial i Ferronikelit hudhen në një hapësirë afër lumit Drenica duke krijuar kodra të skories. Deponia ka sipërfaqe rreth 24 hektarë kurse zona e ndikimit 45 hektarë dhe llogaritet si burim potencial i ndotjes. Përveç mbeturinave të nikelit, këtu hidhen edhe mbeturinat komunale⁴.

Gjykata për Kundërvajtje në Drenas, më 11.10.2011, mbajti seancën gjyqësore sipas fletëparaqitjes për kundërvajtje të bërë kohë më parë nga inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ndaj “NewCo Ferronikeli Complex LLC”⁵. Gjykata mori vendim që ndaj personit juridik të Ferronikelit, t’i shqiptoj dënimin prej 40.000 euro, kurse personit fizik – menaxherit të Ferronikelit iu shqiptua dënimi prej 1500 euro⁶.

Hulumtuesit e QPA-së kanë tentuar të vizitojnë kompleksin industrial Ferronikeli dhe të bisedojnë me drejtuesit e kësaj kompanie rreth shqetësimeve për ndotjen që po i shkaktohet mjedisit si rezultat i veprimtarisë së tyre, por hyrja brenda objektit ka qenë e pamundur. Ndërsa gjatë bisedave me banorët e komunës së Drenasit, ata kanë ngritur shqetësim për nivelin e ndotjes së mjedisit dhe neglizhencën e institucioneve të Kosovës për të adresuar këtë problem. Ata janë ankuar posaçërisht për ndotjen e lumit Drenica për shkak të shkarkimit në këtë lumë të

³ Raport për gjendjen e ajrit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

⁴ Raport(2012): Hotspotet mjedisore në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, fq.54,

⁵ <http://mmph-rks.org/sq/Lajmet/Gjykata-per-Kundervajtje-ne-Drenas-mori-vendim-qe-ndaj-personit-juridik-Feronikelit-ti-shqiptoj-denimin-prej-40000-Euro-176>

⁶ Po aty.

ujit të cilin Ferronikeli e përdor për pastrimin e filtrave dhe për ftohje gjatë prodhimit të nikelit. Peshkatarët kanë thënë se si pasojë e ndotjes së lumit janë zhdukur shumë specie peshqish.

Një raport i revistës hulumtuese Preportr i vitit të kaluar kishte konstatuar se Ferronikeli po e vret lumin Drenica. Në një intervistë për Preportr udhëheqësi i Laboratorit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës Agron Shala, kishte thënë se në bazë të kërkesave që ka bërë Inspektorati, por edhe në bazë të ankesave të banorëve, ekipi i laboratorit ka dalë herë pas here për të bërë monitorime. Sipas tij pas çdo monitorimi ka pasur raste kur kanë dalë edhe me ekspertë ndërkombëtarë dhe çdoherë janë gjetur fakte të cilat tregojnë për ndotjet që shkaktohen nga gypi i kanalizimit që rrjedh prej "Ferronikelit".⁷

NewCo Ferronikeli, i cili shkarkon ujëra me ngarkesë termike, ujëra të procesit dhe ujëra sanitar, nuk ka impiant për pastrimin apo para-trajtimin e tyre⁸. Komuna e Drenasit në vazhdimësi është e ekspozuar edhe ndaj ndotësve tjerë individual dhe kolektiv nëpërmjet hudhjes së mbeturinave, shkarkimit të ujërave të zeza, të cilat zakonisht derdhën në lumin Drenica⁹.

Në një komunikatë për media të vitit 2012, zyrtarë të Ferronikelit thonë se kanë investuar më shumë se 60 milionë euro pas privatizimit dhe prej tyre më shumë se 12 milionë janë investuar mbi çështjet e mjedisit për t'i mundësuar fabrikës të funksionojë në mënyrë të suksesshme.¹⁰ Në faqen e tij të internetit kompleksi Ferronikeli ka prezentuar politikën për mbrojtjen e mjedisit, në të cilën thuhet se ndërmarrja aplikon të gjitha ligjet dhe rregullativat mjedisore që janë të zbatueshme në Bashkimin Evropian.¹¹

MMPH në lejen mjedisore të integruar që ia ka dhënë Ferronikelit në gusht të vitit 2014 e detyron operatorin t'a kontrollojë dhe riparojë sistemin për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave që rrjedhin nga kanali përreth deponisë së skories dhe të bëjë trajtimin e këtyre ujërave para se të shkarkohen në lumin Drenica¹².

⁷ Ferronikeli vret lumin Drenica, tetor 2013 <http://preportr.com/sq/Re-publika/Ferronikeli-vret-lumin-Drenica-340>

⁸ http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kadastr_i_ndotesve__te_ujerave_Shq.pdf fq.25

⁹ Po aty

¹⁰ <http://www.telegrafi.com/ekonomi/lajme-ekonomi/ferronikeli-disa-individ-po-manipulojne-banoret-ne-drenas.html>

¹¹ http://www.cunicoresources.com/b/f/ferronickel_environmental_policy.pdf

¹² MMPH, Leja mjedisore e integruar, NewCo Ferronikeli Complex L.L.C

III.b Ujërat e zeza, mbeturinat dhe gurëthyesit

Përvec Ferronikelit, Drenasi ballafaqohet edhe me ndotës të tjerë siç janë hudhja e mbeturinave, shkarkimi i ujërave të zeza dhe gurëthyesit.

Lumi Drenica që përshkon komunën e Drenasit është i ndotur nga hedhja e mbeturinave si dhe derdhja e kanalizimeve në shtratin e tij¹³. Aktualisht, në këtë komunë janë identifikuar 15 ndotës, 14 prej tyre kolektiv dhe 1 individual¹⁴.

Problematike paraqitet edhe hudhja e mbeturinave, si pasojë e mungesës së deponive, ato hudhën në mënyrë të pakontrolluar. Mungesa e kontejnerëve nëpër fshatra ka ndikuar në formimin e deponive ilegale të mbeturinave të cilat janë prezente sidomos përgjatë magjistrales Drenas-Skenderaj. Pothuajse çdo fshat i Drenasit ka të paktën nga dy deponi të egra të grumbullimit të mbeturinave të cilat e ndotin mjedisin¹⁵.

Gurëthyesit poashtu janë një shkaktar tjetër, të cilët përmes aktivitetit të tyre lirojnë pluhur dhe grimca të tjera. Në Komunën e Drenasit aktualisht janë aktiv 6 gurëthyes¹⁶

¹³ http://www.institutigap.org/documents/58127_DRENASI.pdf fq.3

¹⁴ http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kadastrri_i_ndotesve_te_ujerave_Shq.pdf fq.25

¹⁵ http://www.institutigap.org/documents/58127_DRENASI.pdf fq.3

¹⁶ Po aty fq.3

IV. Programi elektoral i subjekteve politike mbi mjedisin

Çështja e mbrojtjes së mjedisit ka zënë shumë pak vend në agjendën elektorale të subjekteve politike të Kosovës. Për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, QPA nuk ka arritur që të bëjë presionin e duhur te subjektet politike që në programet e tyre zgjedhore t'i kushtojnë më shumë rëndësi ndotjes së mjedisit, posaçërisht në komuna të caktuara. Disa subjekte politike në programet e tyre zgjedhore, i kanë kushtuar rëndësi edhe mjedisit, përderisa disa sosh nuk janë ndalur fare te kjo problematikë.

IV.a Partia Demokratike e Kosovës

PDK në programin e saj strategjik zhvillimor parashihet mes tjerash kompletimin e kornizës ligjore dhe institucionale për sektorin e mjedisit; zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe minimizimit ose ndalimit të atyre veprimtarive ekonomike dhe të tjera, që përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin; koordinimin dhe pjesëmarrjen aktive në iniciativat evropiane dhe ndërkombëtare për sektorin mjedisor; rritjen e vetëdijësimit të publikut, edukimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin mjedisor të vendimmarrjes; kompletimi i legjislacionit mjedisor i harmonizuar me Acquis mjedisor të BE dhe sigurimi i përparimit në zbatimin e tij¹⁷.

IV.b Lidhja Demokratike e Kosovës

LDK-ja angazhohet për strategji që përcakton vlerat kufitare për lirimin e gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë që mbron klimën. Ruajtja e ambientit është një obligim dhe zotim për mirëqenien e brezave të ardhshëm. Kursimi i energjisë, ngritja e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimi i energjisë riprodhuese do të jenë shtylla bartëse të politikës së LDK-së për mbrojtje të ambientit dhe të klimës. LDK-ja do të angazhohet edhe për strategjitë të përshtatshme të shfrytëzimit të tokave nën kushte të ndryshueshme klimatike. Ruajtja e pasurive pyjore dhe investimet në gjelbërimin e zonave, do të jetë me prioritet të veçantë¹⁸.

IV.c Lëvizja Vetëvendosje

Lëvizja Vetëvendosje në programin e saj ka theksuar përkushtimin për përmirësimin e infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e ambientit dhe ngritjen e nivelit të zbatimit të saj; për masa rigorozë ligjore për t'iu kundërvënë dëmtimit të mjedisit; për përkrahjen e përdorimit të energjisë alternative të ripërtëritshme (solare, me erë, riciklim, etj); për ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e emetimit të substancave dhe gazrave të dëmshme nga burimet e tyre (industria, automjetet etj. Themelimi i mekanizmave monitorues, dhe imponimi i zbatimit të ligjeve për ruajtjen e mjedisit dhe për kontrollin e nivelit të ndotjes është theksuar si prioritet për VV¹⁹.

¹⁷ Programi zgjedhor I Partisë Demokratike të Kosovës fq.35

¹⁸ <http://www.ldk-ks.eu/public/uploads/pdf/tresh-1352244646.pdf> fq.17

¹⁹ Programi zgjedhor I Lëvizjes Vetëvendosje fq.111-112

IV.d Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Në programin zgjedhor të AAK-së theksohet se çdo projekt zhvillimor, industrial, urban, bujqësor apo tjetër do të jetë konform standardeve më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit.²⁰

²⁰ <http://www.drejtimi.com/?id=7> fq.136

V. Konkluzionet dhe rekomandimet

Në bazë të gjendjes së prezentuar në këtë raport mund të konkludohet se:

- Komuna e Drenasit, e posaçërisht lumi Drenica, po ndotet si pasojë e veprimtarisë së kompleksit industrial Ferronikeli.
- Krahas shkarkimit të ujërave nga Ferronikeli, lumi Drenica vazhdon të ndotet edhe nga mbeturinat individuale dhe kolektive.
- Ka pasur pak hulumtime mbi dëmet që po I shkakton ndotja e mjedisit shëndetit të popullatës së Drenasit si dhe florës e faunës.
- Qytetarët kanë njohuri të pakta për rrezikun nga ndotja e mjedisit dhe masat që duhet të ndërmerren për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes.
- Nuk ka komunikim të duhur mes institucioneve qendrore, lokale, operatorëve ekonomik e qytetarëve për zgjidhjen e problemeve me interes të përbashkët

Rrjedhimisht rekomandohet që:

- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i ndotjes së mjedisit në komunën e Drenasit. Kjo duhet të jetë prioritet në këtë komunë në krahasim me komunat tjera ku zhvillimi i industrisë së rëndë , sidomos asaj metalurgjike është shumë i vogël ose nuk ekziston fare.
- Riciklimi i mbeturinave në Drenas jo vetëm që do ndihmonte në mbrojtjen e mjedisit,por do të ndihmonte zhvillimin ekonomik të këtij rajoni
- Rregullimi i shtratit të lumit Drenica do të përmirësonte dukshëm gjendjen e këtij lumi
- Të kompletohet infrastruktura ligjore në Kosovë për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me standardet e BE-së, ndërsa Kuvendi Komunal i Drenasit të nxjerrë rregullore e akte tjera nënligjore në fushën e mjedisit si dhe të përmirësojë mekanizmin e dhënies së lejeve mjedisore dhe pëlqimit mjedisor
- Të bëhet monitorimi i rregullt i zbatimit të legjislacionit dhe ndëshkimi i shkelësve të ligjit
- Të vendoset një dialog i rregullt ndërmjet qeverisë, pushtetit lokal, kompanive që ndotin ambientin (Ferronikelit në këtë rast) dhe qytetarëve për të përmirësuar gjendjen dhe parandaluar ndotjen e mëtutjeshme të mjedisit